



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK

Nr. 3243/ 13 prot

Datë 31.01.2024

V E N D I M
Nr. 122 /2024

Komisioni i Prokurimit Publik, i përbërë nga:

Jonaid Myzyri	Kryetar
Anila Malaj	Anëtar
Kreshnik Ternova	Anëtar

Në mbledhjen e datës 31.01.2024 shqyrtoi ankesën me:

Objekt:

Shfuqizimi i vendimit të Komisionit të Vlerësimit të Ofertave mbi skualifikimin e ofertës të paraqitur nga operatori ekonomik “LIBRARI DYRRAHU” SHPK në procedurën e prokurimit “*E Hapur e Thjeshtuar*”, me Nr. REF-82208-10-04-2023, me objekt “Blerje materiale kancelarie për Bashkinë Fushë-Arrëz”, me fond limit 1,384,166 lekë pa TVSh, zhvilluar më datë 19.12.2023, nga autoriteti kontraktor, Bashkia Fushë-Arrëz.

Të mbetet i skualifikuar operatori ekonomik “InfoSoft Office” SHPK

Shfuqizimi i vendimit të Komisionit të Vlerësimit të Ofertave mbi kualifikimin e ofertës të paraqitur nga operatori ekonomik “InfoSoft Office” SHPK” SHPK, në procedurën e prokurimit sipër cituar.

Ankimues:

Operatori ekonomik “LIBRARI DYRRAHU” SHPK me Nipt. L91418502J dhe adresë: Autostrada Tiranë-Durrës km. i fundit, zona kadastrale nr.8517, Durrës.

Operatori ekonomik “InfoSoft Office” SHPK me Nipt J62426002Q. Adresa: Autostrada Tiranë-Durrës, Km. 8, Kashar, Tiranë.

Autoriteti Kontraktor:	Bashkia Fushë-Arrëz <i>Adresa: Qendër Fushë-Arrëz</i>
Subjekt i Interesuar	Operatori ekonomik “InfoSoft Office” SHPK me Nipt J62426002Q. <i>Adresa: Autostrada Tiranë-Durrës, Km. 8, Kashar, Tiranë.</i>
Baza Ligjore:	Ligji nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, Vendimi i Këshillit të Ministrave nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, Vendimi i Komisionit të Prokurimit Publik Nr. 766/2021, datë 13.10.2021 “Për miratimin e rregullave “Për Organizimin dhe Funksionimin e Komisionit të Prokurimit Publik”, Neni 4 i Vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik nr. 500/2020 datë 5.11.2020 “Rregullore për Marrjen e Masave Organizative për Ushtrimin e Veprimtarisë së Institucionit të Komisionit të Prokurimit Publik gjatë gjendjes së pandemisë së shkaktuar nga COVID -19”.

Komisioni i Prokurimit Publik, pasi dëgjoi relatorin e çështjes, shqyrtoi parashtrimet me shkrim të ankimuesve, dokumentacionin e paraqitur nga autoriteti kontraktor dhe pasi diskutoi çështjen në tërësi,

Vëren:

I

Vlerësimi paraprak

I.1. Vlera limit e përlllogaritur për procedurën e prokurimit objekt-ankimi është nën kufirin e ulët monetar, ndaj shqyrtimi dhe vendimmarrja do të bëhet nga tre anëtarë, në përputhje me pikën 1, të nenit 30 të ligjit nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik”.

I.2. Operatorët ekonomikë kanë *prima facie* interes në këtë procedurë prokurimi dhe për këtë arsye legjitimohen për të paraqitur ankesë në lidhje me të.

I.3. Operatorët ekonomikë ankimues kanë paraqitur ankesë pranë autoritetit kontraktor dhe njëherazi pranë Komisionit të Prokurimit Publik.

I.4. Pas shqyrtimit paraprak të ankesave, mbështetur në dokumentacionin e dërguar nga operatorët ekonomikë ankimues, Komisioni i Prokurimit Publik konstatoi, se këta të fundit janë operatorë ekonomikë ankimues për të njëjtën procedurë prokurimi, ndaj edhe ankimet e tyre duhet të bashkohen e të shqyrtohen në një gjykim të vetëm.

I.5. Ankimuesit kanë respektuar afatet ligjore të paraqitjes së ankesës pranë autoritetit kontraktor dhe Komisionit të Prokurimit Publik.

II

Rrethanat e çështjes

II.1. Në datën 05.10.2023, është publikuar në Sistemin e Prokurimeve Elektronike procedura e prokurimit “*Procedurë e Hapur e Thjeshtuar*”, me Nr. REF-82208-10-04-2023, me objekt “Blerje materiale kancelarie për Bashkinë Fushë-Arrëz”, me fond limit 1,384,166 lekë pa TVSh, zhvilluar më datë 19.12.2023, nga autoriteti kontraktor, Bashkia Fushë-Arrëz.

II.2. Në datën 19.12.2023, autoriteti kontraktor zhvilloi procedurën e prokurimit objekt-ankimi.

II.3. Nga verifikimi në sistemin e prokurimit elektronik (SPE), si dhe referuar informacionit të autoritetit kontraktor të dorëzuar pranë Komisionit të Prokurimit Publik, rezulton, se në datën 22.12.2023, është bërë klasifikimi i operatorëve ekonomikë pjesëmarrës, duke i njoftuar me anë të sistemit të prokurimeve elektronike (S.P.E.), mbi rezultatet e vlerësimit të ofertave ekonomike si më poshtë:

1. InfoSoft Office ShPK	me ofertë	795.772 ⁷¹	Lekë pa TVSh	skualifikuar
2. LIBRARI DYRRAHU ShPK	“	880.000	“	skualifikuar
3. Marketing & Distribution ShPK	“	980.148	“	kualifikuar
4. TIM ShPK	“	1,127,488	“	skualifikuar

II.4. Në datën 26.12.2023, autoriteti kontraktor ka publikuar njoftim - fituesi paraprak në Sistemin e Prokurimeve Elektronike.

II.5. Në datën 29.12.2023, pranë Komisionit të Prokurimit Publik, është protokolluar ankesa me nr. 3243 prot., e operatorit ekonomik “LIBRARI DYRRAHU” SHPK, për procedurën e prokurimit “*E Hapur e Thjeshtuar*”, me Nr. REF-82208-10-04-2023, me objekt “Blerje materiale kancelarie për Bashkinë Fushë-Arrëz”, me fond limit 1,384,166 lekë pa TVSh, zhvilluar më datë 19.12.2023, nga autoriteti kontraktor, Bashkia Fushë-Arrëz.

Nga shqyrtimi paraprak i ankesës, u konstatua, se objekti i saj lidhet me kundërshtimin e vendimit të Komisionit të Vlerësimit të Ofertave, mbi skualifikimin e ofertës së operatorit ekonomik “LIBRARI DYRRAHU” SHPK, nga procedura e prokurimit të sipërcituar, si dhe pretendimin që të mbetet i skualifikuar operatori ekonomik “InfoSoft Office” SHPK.

II.6. Në përputhje me nenin 112 “*Veprimet paraprake*” të Ligjit nr.162/2020 “*Për Prokurimin Publik*”, Komisioni i Prokurimit Publik me marrjen e ankesës, e publikoi atë në bazën e të dhënave të tij, e cila përmban të dhëna për: a) ankimuesin, adresën dhe NUIS-in; b) të dhëna të plota për procedurën e prokurimit (objekt, numër reference, fond limit, datën e zhvillimit të procedurës), si dhe është publikuar formulari i publikimit Nr. 3243/2 prot., datë 03.01.2024

lidhur me pretendimet e ankimuesit “**LIBRARI DYRRAHU**” SHPK, mbi arsyet e skualifikimit të ofertës së tij dhe pretendime për operatorin ekonomik “InfoSoft Office” ShPK.

II.6.1. Referuar Sistemit të Prokurimeve Elektronike, Raportit Përmbledhës së procedurës sipër cituar, si edhe Formularit të Njoftimit të Fituesit Paraprak dt. 26.12.2023, Operatori ekonomik ankimues “Librari Dyrrahu” SHPK, rezulton të jetë skualifikuar nga procedura sipër cituar me arsyet e skualifikimit si më poshtë vijon:

- **Arsyet e skualifikimit:**

O.E "LIBRARI DYRRAHU" nuk plotëson kriteret sipas DST-së, si më poshtë:

Vërtetimi i taksave Nr. 263 Regj. DTTV, datë 11.04.2023, rezulton i paqartë lidhur me likuidimin e detyrimeve të taksave, pra nuk është i përcaktuar qartë viti i shlyerjes së detyrimeve, të kërkuar në DST sipas pikës 2.2, “Kapaciteti ekonomik dhe financiar”, pika 2.2.2.

Mungon paraqitja e formularit përmbledhës të vetëdeklarimit, të kërkuar në DST sipas pikës 2, “Kriteret e veçanta të kualifikimit”, gërma a, shtojca 8.

Mungon licencimi për furnizime të këtij lloji ose ekuivalente, të kërkuar në DST sipas pikës 2.3, “Kapaciteti teknik”, pika 2.3.1.

II.7. Nëpërmjet shkresës nr. 61/1 prot., datë 09.01.2024, protokolluar me tonën me nr.3243/4, datë 12.01.2024, autoriteti kontraktor ka paraqitur “*Informacion*” pranë Komisionit të Prokurimit Publik, si dhe vendimin me Nr. 61, datë 09.01.2024 të KSHA-së, lidhur me trajtimin e ankesës së operatorit ekonomik ankimues, duke vendosur mospranimin e ankesës së paraqitur nga operatori ekonomik ankimues “LIBRARI DYRRAHU” SHPK.

II.8. Nëpërmjet shkresës protokolluar me tonën me Nr. 3243/5, datë 15.01.2024 me objekt: “*Informacion shtesë*”, operatori ekonomik “LIBRARI DYRRAHU” ShPK pretendon, se është skualifikuar nga procedura e prokurimit objekt - ankimi me një arsye skualifikimi e konkretisht: *Vërtetimi i taksave Nr. 263 Regj. DTTV, datë 11.04.2023, rezulton i paqartë lidhur me likuidimin e detyrimeve të taksave, pra nuk është i përcaktuar qartë viti i shlyerjes së detyrimeve, të kërkuar në DST sipas pikës 2.2, “Kapaciteti ekonomik dhe financiar”, pika 2.2.2.*

II.9. Nisur nga arsyet e skualifikimit të ankimuesit, me shkresën Nr.3243/8 prot., datë 19.01.2024, me objekt “*Njoftim për seancë dëgjimore pranë Komisionit të Prokurimit Publik*”, Komisioni gjykoi të nevojshme zhvillimin e një seance dëgjimore në mjediset e institucionit të KPP-së, me një përfaqësues të operatorit ekonomik ankimuesit, i cili disponon të dhënat për t’u futur në Sistemin e Prokurimit Elektronik, me qëllim verifikimin e arsyeve të skualifikimit.

II.10. Më datë 22.01.2024, në ora 12⁰⁰, pranë ambienteve të KPP-së u mbajt seanca dëgjimore sipër cituar, me përfaqësues të OE. Administratori i shoqërisë “LIBRARI DYRRAHU” ShPK dhe punonjësj M.T, personi përgjegjës për procedurën.

II.10.1 Pas verifikimeve në sistem, nga OE ankimues u printuan dy dokumente nga rubrika mesazhe e operatorit ekonomik ankimues.

II.11. Me shkresën nr. 3243/9 prot., datë 24.01.2024, Komisioni i Prokurimit Publik, nisur nga pretendimet e ankimuesit mbi arsyet e skualifikimit, i kërkoi autoritetit kontraktor të përcjellë pranë KPP-së, kopje të Procesverbalit të Vlerësimit të Ofertave, të mbajtur nga KVO, për procedurën objekt ankimi.

II.11.1. Me shkresën me nr. 250/1 prot., datë 26.01.2024, protokolluar me tonën me nr. 3243/10, datë 29.01.2024, me objekt “Informacion”, autoriteti kontraktor ka përcjellë kopje të procesverbalit të vlerësimit të ofertave nga KVO.

II.12. Në datën 03.01.2024, pranë Komisionit të Prokurimit Publik, është protokolluar ankesa me nr. 07/2024, e operatorit ekonomik “**InfoSoft Office**” SHPK, për procedurën e prokurimit “*E Hapur e Thjeshtuar*”, me Nr. REF-82208-10-04-2023, me objekt “Blerje materiale kancelarie për Bashkinë Fushë-Arrëz”, me fond limit 1,384,166 lekë pa TVSh, zhvilluar më datë 19-12-2023, nga autoriteti kontraktor, Bashkia Fushë-Arrëz.

II.12.1 Në përputhje me nenin 112, “*Veprimet paraprake*” të Ligjit nr.162/2020 “*Për Prokurimin Publik*”, Komisioni i Prokurimit Publik me marrjen e ankesës, e publikoi atë në bazën e të dhënave të tij, e cila përmban të dhëna për: a) ankimuesin, adresën dhe NUIS-in; b) të dhëna të plota për procedurën e prokurimit (objekt, numër reference, fond limit, datën e zhvillimit të procedurës), si dhe është publikuar formulari i publikimit Nr.7/2 prot., datë 04.01.2024, lidhur me pretendimet e ankimuesit “InfoSoft Office” SHPK.

Nga shqyrtimi paraprak i ankesës, u konstatua, se objekti i saj lidhet me kundërshtimin e vendimit të Komisionit të Vlerësimit të Ofertave, mbi skualifikimin e ofertës së operatorit ekonomik “InfoSoft Office” SHPK, nga procedura e prokurimit të sipërcituar.

II.13. Nëpërmjet shkresës nr. 62/1 prot., datë 09.01.2024, protokolluar me tonën me nr. 07/4, datë 15.01.2024, autoriteti kontraktor ka paraqitur “*Informacion*” pranë Komisionit të Prokurimit Publik, si dhe vendimin me Nr. 62, datë 09.01.2024 të KSHA-së, mbi trajtimin e ankesës së operatorit ekonomik ankimues, duke vendosur mospranimin e ankesës së paraqitur nga operatori ekonomik ankimues “InfoSoft Office” SHPK.

II.14. Në përputhje me nenin 113 të Ligjit Nr. 162/2020 “*Për Prokurimin Publik*” nuk janë paraqitur argumente nga operatorë të tjerë të interesuar.

III

Komisioni i Prokurimit Publik

pas shqyrtimit të ankesës dhe dokumentacionit të përcjellë nga autoriteti kontraktor,

Arsyeton

III.1. Në lidhje me pretendimet e operatorit ekonomik “LIBRARI DYRRAHU” SHPK mbi skualifikimin e ofertës së tij nga procedura e prokurimit me arsyen:

“O.E "LIBRARI DYRRAHU" nuk plotëson kriteret sipas DST-së, si vijon:

Vërtetimi i taksave Nr. 263 Regj. DTTV, datë 11.04.2023, rezulton i paqartë lidhur me likuidimin e detyrimeve të taksave, pra nuk është i përcaktuar qartë viti i shlyerjes së detyrimeve, të kërkuar në DST sipas pikës 2.2, “Kapaciteti ekonomik dhe financiar”, pika 2.2.2.”

[...] Sqarojmë se bazuar në klasifikimin e ofertave nga AK, rezulton se OE "LIBRARI DYRRAHU" ShPK është skualifikuar në kundërshtim me dispozitat ligjore. Nga ana jonë në përmbushje të kriterit 2.2.2. është dorëzuar në SPE dokumenti i lëshuar nga Bashkia Durrës nga ku rezulton se nuk kemi detyrime të papaguara. Vërtetimi është në përmbushje të kriterit 2.2.2 ... Kërkojmë që AK të rivlerësojë procedurën duke kualifikuar ofertën tonë.[....]

III.1.1 Autoriteti Kontraktor ka publikuar në DST shtojcën 7, Kriteret të Veçanta të kualifikimit, 2.2 Kapaciteti ekonomik dhe financiar:

2.2.2 Vërtetim që ka paguar taksat vendore ku Operatori Ekonomik ka ushtruar Aktivitet sipas QKB.

III.1.2. Operatori ekonomik në përmbushje të kriterit kualifikues 2.2.2, ka paraqitur në SPE si pjesë të ofertës së tij dokumentin me emërtim:

Vërtetim_taksa_vendore, me përmbajtje si vijon:

Vërtetim me Nr. 263 Regj DTTV, datë 11.04.2023, Me anë të cilit se subjekti “Librari Dyrrahu” SHPK me aktivitet Librari & Tregti Artikuj Shkollor” me Administrator Z. I. B me adresë: Lagjja 3 , Rr. Egnatia, i regjistruar pranë Bashkisë Durrës, me Nipt L91418502J nuk ka detyrime të palikujduara deri në datën e marrjes së vërtetimit.

III.1.3. Në nenin 2 “Qëllimi” të ligjit nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, parashikohet shprehimisht se:

“Qëllim i këtij ligji është: a) të rrisë eficientë dhe efikasitetin në procedurat e prokurimit publik; b) të sigurojë mirëpërdorim të fondeve publike dhe të ulë shpenzimet procedurale; c) të nxisë pjesëmarrjen e operatorëve ekonomikë në procedurat e prokurimit publik; ç) të nxisë konkurrencën ndërmjet operatorëve ekonomikë; d) të sigurojë një trajtim të barabartë dhe jodiskriminues për të gjithë operatorët ekonomikë, pjesëmarrës në procedurat e prokurimit publik; dh) të sigurojë integritet, besim publik dhe transparencë në procedurat e prokurimit publik.”.

Ndërkohe në nenin 3 “Parime të përgjithshme” të ligjit nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, parashikohet shprehimisht se:

“1. Autoritetet dhe entet kontraktore garantojnë trajtim të barabartë dhe jodiskriminues për operatorët ekonomikë, si dhe veprojnë me transparencë e në mënyrë proporcionale. 2. Autoritetet dhe entet kontraktore nuk duhet të shmangin fushën e zbatimit të këtij ligji ose të

ngushtojnë në mënyrë artificiale konkurrencën. Konkurrenca konsiderohet se është ngushtuar artificialisht kur prokurimi përgatitet me qëllimin për të favorizuar ose dëmtuar në mënyrë të padrejtë operatorë ekonomikë të caktuar. 3. Autoritetet dhe entet kontraktore janë të detyruara të zbatojnë detyrimet e përcaktuara në legjislacionin mjedisor, social e të punës dhe në dispozitat e marrëveshjeve dhe konventat ndërkombëtare, të ratifikuara në përputhje me Kushtetutën.”.

III.1.4. Në nenin 77, pika 1 dhe 4 “Kërkesat për kualifikim” të ligjit 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, parashikohet shprehimisht se:

“1. Autoritetet ose entet kontraktore përcaktojnë kërkesat për kualifikim për operatorët ekonomikë bazuar në: a) përshtatshmërinë për të kryer veprimtarinë profesionale; b) gjendjen ekonomike dhe financiare; c) aftësinë teknike dhe profesionale. Kërkesat kufizohen vetëm në ato që janë të përshtatshme për të garantuar që një kandidat ose ofertues të ketë kapacitetet juridike, financiare dhe aftësitë teknike e profesionale për të zbatuar kontratën që do të jepet. Të gjitha kërkesat duhet të kenë lidhje dhe të jenë proporcionale me objektin e kontratës.”.

4. Në lidhje me aftësitë teknike dhe profesionale, autoritetet ose entet kontraktore mund të vendosin kërkesa që garantojnë se operatorët ekonomikë zotërojnë burimet e nevojshme njerëzore e teknike, si dhe përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën sipas një standardi të përshtatshëm cilësie. Autoritetet ose entet kontraktore, në veçanti, mund të kërkojnë që operatorët ekonomikë të kenë një nivel të mjaftueshëm përvojë që vërtetohet nga referenca të përshtatshme nga kontratat e zbatuara në të shkuarën. Aftësia profesionale e operatorëve ekonomikë për të ofruar shërbimin, punën, mallin vlerësohet në lidhje me aftësitë organizative, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm për të zbatuar kontratën, siç është përshkruar nga autoriteti ose enti kontraktor në njoftimin e objektit të kontratës.”.

Ndërsa në nenin 92/3 të LPP-së përcaktohet se:

“3. Autoriteti ose enti kontraktor, në zbatim të pikës 4 të këtij neni, vlerëson një ofertë të vlefshme vetëm nëse ajo është në përputhje me të gjitha kërkesat dhe specifikimet e përcaktuara në njoftimin e kontratës dhe në dokumentet e tenderit, pa rënë ndesh me përcaktimet e nenit 38 të këtij ligji...”.

III.1.5 Në nenin 40 “Kërkesa të veçanta për kontratat e mallrave” pikat 1, 3 dhe 8, të Vendimit Nr. 285, datë 19.05.2021, të Këshillit të Ministrave “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, parashikohet se:

1. Në procedurat e prokurimit për mallra, autoriteti/enti kontraktor parashikon sasinë e mallrave që do të lëvrojë, si dhe grafikonin e lëvrimit të mallrave.

3. Kërkesat e veçanta të kualifikimit duhet të përfshijnë të gjitha kriteret specifike, në përputhje me nenin 77, të LPP-së. Kriteret duhet të jenë në përpjesëtim dhe të lidhura ngushtë me aftësinë zbatuese, natyrën dhe vlerën e kontratës. Në çdo rast, autoriteti/enti kontraktor duhet të përcaktojë dokumentet konkrete që duhet të paraqesin operatorët ekonomikë për përmbushjen e këtyre kriterëve.

8. *Autoriteti/enti kontraktor, përveç kërkesave të parashikuara në këtë nen, mund të përcaktojë kritere të tjera të veçanta, në varësi të objektit që prokurohet, të cilat i vlerëson të nevojshme për ekzekutimin me sukses të kontratës.*

III.1.6. Referuar frymës së legjislacionit për prokurimin publik, vendosja e kritereve të veçanta për kualifikim ka si synim kryesor që t'i shërbejë autoritetit kontraktor për njohjen e gjendjes dhe kapaciteteve të operatorëve ekonomikë, të cilët nëpërmjet dokumentacionit të paraqitur duhet të vërtetojnë se zotërojnë kualifikimet e nevojshme teknike, profesionale, kapacitetet ekonomike, financiare dhe organizative, makineritë, pajisjet e asete të tjera fizike, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur si dhe personelin e nevojshëm, gjithçka në funksion të realizimit me sukses të kontratës. Kriteret kualifikuese të përcaktuara nga autoriteti kontraktor janë të detyrueshme për t'u përmbushur nga të gjithë ofertuesit ekonomikë pjesëmarrës në një procedurë prokurimi. Njësia përgjegjëse për prokurimin ka për detyrë të mirëargumentojë dhe formulojë qartë kriteret për kualifikim me qëllim përmbushjen e tyre me korrektësi nga operatorët ekonomikë të interesuar të marrin pjesë në procedurat e prokurimit.

Autoriteti kontraktor do të konsiderojë një ofertë të vlefshme, vetëm nëse ajo është në përputhje me të gjitha kërkesat dhe specifikimet teknike dhe kriteret për kualifikim të përcaktuara në njoftimin e kontratës dhe në dokumentet e tenderit. Për pasojë, Komisioni gjykon, se operatorët ekonomikë pjesëmarrës në një procedurë prokurimi duhet të plotësojnë vetëm kërkesat e vendosura në dokumentet e tenderit, e rrjedhimisht, vlerësimi e kualifikimi i tyre duhet të bëhet në përputhje vetëm me këto kërkesa.

Nga shqyrtimi i dokumenteve të tenderit të procedurës objekt-ankimi, KPP konstaton, se me dokumentacionin e paraqitur, operatori ekonomik "LIBRARI DYRRAHU" SHPK ka plotësuar kriterin e mësipërm të vendosur nga autoriteti kontraktor në dokumentet standarde të tenderit, pasi nga verifikimi i përmbajtjes së dokumentit rezulton, se dokumenti ka këtë përmbajtje:[... "*Librari Dyrrahu*" SHPK me aktivitet *Librari & Tregti Artikuj Shkollor*" me Administrator Z. I. B me adresë: *Lagjja 3 , Rr. Egnatia, i regjistruar pranë Bashkisë Durrës, me Nipt L91418502J nuk ka detyrime të palikujduara deri në datën e marrjes së vërtetimit....*] është në përputhje me kriterin e kërkuar në **pikën 2.2.2** *Vërtetim që ka paguar taksat vendore ku Operatori Ekonomik ka ushtruar Aktivitet sipas QKB.*

Referuar sa më sipër Komisioni gjykon, se operatori ekonomik ka përmbushur kriterin kualifikues me paraqitjen e dokumentit të paraqitur.

Komisioni arrin në konkluzionin, se dokumentacioni i paraqitur nga operatori ekonomik ankimues në procedurën e prokurimit, plotëson kërkesat e autoritetit kontraktor dhe konsiderohet i vlefshëm. KPP gjykon, se arsyeja e skualifikimit për operatorin ekonomik në rastin konkret, nuk është në përputhje me kriterin e kualifikimit të vendosur nga autoriteti kontraktor për plotësimin e këtij kriteri kualifikues të kapaciteteve teknike, pasi nga shqyrtimi i dokumentacionit dhe informacionit të ardhur nga autoriteti kontraktor për procedurën e prokurimit objekt-ankimi, nuk rezulton që ky i fundit të këtë bërë një hetim të thelluar apo verifikim për dokumentin e OE ankimues. Akoma më tej, Komisioni referuar Nenit 82, pika 2 të Ligjit 162/2020 "*Për Prokurimin Publik*", ku citohet, se *Në çdo kohë gjatë procedurës,*

autoriteti ose enti kontraktor mund t'u kërkojë ofertuesve dhe kandidatëve sqarime dhe dokumente mbështetëse për këto sqarime, kur kjo është e nevojshme për të garantuar zbatimin korrekt të procedurës., vëren, se legjislacioni i prokurimit publik i njeh të drejtën autoritetit kontraktor, por dhe vetë ky i fundit ka rezervuar në dokumentet standarde të tenderit (Shqyrtimi i ofertave, pika 17/1. Sqarimi i ofertave, Autoriteti Kontraktor, gjatë procesit të shqyrtimit dhe vlerësimit të ofertave, mund të kërkojë sqarime nga operatorët ekonomikë ofertues.), si edhe të drejtën e verifikimit apo sqarimit mbi vërtetësinë dhe saktësinë e informacionit që përmbajnë dokumentet e paraqitura nga ata dhe më pas të marrë vendim lidhur me to.

Komisioni i Prokurimit Publik, gjykon, se është me vend të theksojë rolin e posaçëm që ka autoriteti kontraktor, për vetëcilësimin e tij ligjor, si autoritet me interes dhe përgjegjësi thelbësore për realizimin e suksesshëm të kontratës. KPP sjell në vëmendje, se referuar rregullave të prokurimit publik, është pikërisht autoriteti kontraktor ai që brenda kuadrit ligjor ushtron të drejtën e tij mbi kryerjen e verifikimeve mbi vërtetësinë e dokumentacionit të ofertave si dhe monitoron me rigorozitet zbatimin e kontratës, për t'u siguruar nëse cilësia e mallrave, dhe mënyra e lëvritimit në kohë, janë në përputhje me kërkesat e autoritetit kontraktor përcaktuar dhe në kontratë.

Në këto kushte, Komisioni gjykon, se skualifikimi i operatorit ekonomik ankimues nga ana e autoritetit kontraktor nuk është i drejtë

Për sa më sipër, pretendimi i ankimuesit qëndron.

III.2. Në lidhje me arsyet e skualifikimit të operatorit ekonomik “LIBRARI DYRRAHU” SHPK, Komisioni referuar Sistemit të Prokurimeve Elektronike, Raportit Përmbledhës të Procedurës sipër cituar, si edhe Formularit të Njoftimit të Fituesit Paraprak dt. 26.12.2023, konstaton, se operatori ekonomik ankimues “Librari Dyrrahu” SHPK rezulton të jetë skualifikuar nga procedura sipër cituar, me arsyet e skualifikimit si më posht vijon:

- **Arsyet e skualifikimit:**

O.E "LIBRARI DYRRAHU" nuk plotëson kriteret sipas DST-së, si më poshtë:

Vertetimi i taksave Nr. 263 Regj. DTTV, datë 11.04.2023, rezulton i paqartë lidhur me likuidimin e detyrimeve të taksave, pra nuk është i përcaktuar qartë viti i shlyerjes së detyrimeve, të kërkuar në DST sipas pikës 2.2, “Kapaciteti ekonomik dhe financiar”, pika 2.2.2.

Mungon paraqitja e formularit përmbledhës të vetëdeklarimit, të kërkuar në DST sipas pikës 2, “Kriteret e veçanta të kualifikimit”, gërma a, shtojca 8.

Mungon licencimi për furnizime të këtij lloji ose ekuivalente, të kërkuar në DST sipas pikës 2.3, “Kapaciteti teknik”, pika 2.3.1.

III.2.1. Nëpërmjet shkresës protokolluar me tonën me Nr. 3243/5, datë 15.01.2024, me objekt: “Informacion shtesë”, operatori ekonomik “LIBRARI DYRRAHU” ShPK pretendon, se është skualifikuar nga procedura e prokurimit objekt - ankimi me një arsye skualifikimi, e

konkretisht: □ *Vërtetimi i taksave Nr. 263 Regj. DTTV, datë 11.04.2023, rezulton i paqartë lidhur me likuidimin e detyrimeve të taksave, pra nuk është i përcaktuar qartë viti i shlyerjes së detyrimeve, të kërkuar në DST sipas pikës 2.2, “Kapaciteti ekonomik dhe financiar”, pika 2.2.2.*

III.2.2. Me shkresën Nr. 3243/8 prot., datë 19.01.2024, nisur nga pretendimet mbi arsyet e skualifikimit të ankimuesit, Komisioni i Prokurimit Publik gjykoi të nevojshme zhvillimin e një seance dëgjimore në mjediset e institucionit të KPP-së, me një përfaqësues nga ana ankimuesit, i cili disponon të dhënat për t'u futur në llogarinë e subjektit në Sistemin e Prokurimit Elektronik, me qëllim verifikimin e arsyeve të skualifikimit.

Më datë 22.01.2024, në ora 12⁰⁰, pranë ambienteve të KPP-së, u mbajt seanca dëgjimore sipër cituar, me përfaqësues të OE ankimues, Administratori i shoqërisë “LIBRARI DYRRAHU” ShPK dhe punonjësja M.T, personi përgjegjës për procedurën.

Komisioni i kërkoi përfaqësuesit të OE, të logohej në llogarinë e tij në sistemin e prokurimeve elektronike. Në prani të të dyja palëve, përfaqësuesi i subjektit ankimues, u logua në llogarinë e tij, nga ku rezultoi, se në rubrikën “Mesazhe” të subjektit “LIBRARI DYRRAHU” ShPK, ka marrë mesazhe mbi vlerësimin e ofertes së tij.

Pas logimit në sistem nga përfaqësuesja e OE “Librari Dyrrahu” ShPK, Komisioni kërkoi t'i vihej në dispozicion mesazhi që ankimuesi ka marrë në lidhje me arsyet e skualifikimit në SPE. Operatori ekonomik vuri në dispozicion të KPP-së (dy print screen) printime të pamjes së dokumenteve të AK-së drejtuar ankimuesit në lidhje me arsyet e skualifikimit, e konkretisht:

Mesazh mbi skualifikimin e OE “Librari Dyrrahu” ShPK nga procedura e tenderit dhe

Mesazh mbi Vlerësimet për tenderin “Blerje materiale kancelarie për Bashkinë Fushë-Arrëz”(Faza e vlerësimit të tenderit) si vijon:

Operatorët ekonomikë	vlera	Refuzuar	Arsye
LIBRARI DYRRAHU	880000	Po	□ <i>Vërtetimi i taksave Nr. 263 Regj. DTTV, datë 11.04.2023, rezulton i paqartë lidhur me likuidimin e detyrimeve të taksave, pra nuk është i përcaktuar qartë viti i shlyerjes .</i>

Komisioni administroi në dosje dy dokumentet e hapura nga përfaqësuesi i OE “Librari Dyrrahu” ShPK në seancën dëgjimore të datës 22.01.2024, në ora 12⁰⁰, pranë ambienteve të KPP-së.

III.2.3. Me shkresën nr. 3243/9 prot., datë 24.01.2024, Komisioni i Prokurimit Publik, nisur nga pretendimet e ankimuesit mbi arsyet e skualifikimit, i kërkoi autoritetit kontraktor të përcjellë pranë KPP-së kopje të Procesverbalit të Vlerësimit të Ofertve, të mbajtur nga KVO, për procedurën objekt - ankimi.

Me shkresën nr. 250/1 prot., datë 26.01.2024, protokolluar me tonën me nr. 3243/10, datë 29.01.2024, me objekt “Informacion”, autoriteti kontraktor ka përcjellë kopje të proces-

verbalit me Nr.4, datë 22.12.2023, mbi vlerësimin e ofertave nga KVO, të operatorëve ekonomikë pjesmarrës në procedurën e prokurimit.

III.2.4. Komisioni i Prokurimit Publik gjykon mbi dokumentacionin e procedurës së prokurimit publikuar në SPE për shqyrtimin e ankesave mbi kundërshtimin e vendimit të Komisionit të Vlerësimit të Ofertave. Referuar pretendimeve të ankimuesit vërehet, se operatori “Librari Dyrrahu” ShPK, ankimon një arsye skualifikimi të KVO-së për ofertën e tij, referuar njoftimit të mbërritur në seksionin mesazhe.

Komisioni, referuar Sistemit të Prokurimeve Elektronike, Raportit Përmbledhës të Procedurës sipër cituar, si edhe Formularit të Njoftimit të Fituesit Paraprak, dt. 26.12.2023, vëren se, operatori ekonomik “Librari Dyrrahu” ShPK është skualifikuar me tri arsye skualifikimi, cituar në pikën III.2. të këtij vendimi.

Referuar procesverbalit të Vlerësimit të Ofertave me nr. 4, datë 22.12.2023, mbajtur nga Komisioni i Vlerësimit të Ofertave, përcjellë pranë KPP-së, konstatohet, se operatori ekonomik “Librari Dyrrahu” ShPK është skualifikuar me tri arsye skualifikimi.

Referuar sa më sipër, Komisioni vëren, se autoriteti kontraktor nuk ka vënë në dijeni e ankimuesin për të gjitha arsyet e skualifikimit të ofertës së tij, e si rrjedhojë, ky i fundit i ka mohuar operatorit ekonomik të skualifikuar “Librari Dyrrahu” ShPK, të drejtën e ankimimit për të gjitha arsyet e skualifikimit. Rrjedhimisht mosvënia në dijeni e ankimuesit mbi arsyet e skualifikimit nga autoriteti kontraktor, ka cenuar interesin e ligjshëm të operatorit ekonomik “Librari Dyrrahu” ShPK të kundërshtojë me ankesë arsyet e skualifikimit të tij nga AK, në vlerësimin e ofertës së ankimuesit.

Në jurisprudencën e saj *Inter Allia*, Gjykata Kushtetuese e Republikës së Shqipërisë në vendimin nr. 12/2014 datë 17.03.2014 është shprehur, se “*Siguria juridike nënkupton, ndërmjet të tjerash, garantimin e besueshmërisë së individit tek shteti, institucionet e tij dhe tek aktet që ato nxjerrin*”. Në rastin konkret, parimi i sigurisë juridike në kuptimin material të tij, konsiderohet edhe moscenimi i të drejtave të fituara dhe i pritshmërive të ligjshme që garantojnë aktet në fuqi.

Komisioni i Prokurimit Publik gjykon, se autoriteti kontraktor për procedurat e prokurimit të cilat realizon, duhet të garantojë respektimin e parashikimeve ligjore në fuqi dhe parimeve të transparencës dhe efiçencës.

Nga shqyrtimi i dosjes administrative, jemi përpara faktit kur AK ka skualifikuar ankimuesin me tri arsye skualifikimi dhe nga ana tjetër ankimuesi është njoftuar për arsyen e parë të skualifikimit □ *Vërtetimi i taksave Nr. 263 Regj. DTTV, datë 11.04.2023, rezulton i paqartë lidhur me likuidimin e detyrimeve të taksave, pra nuk është i përcaktuar qartë viti i shlyerjes së detyrimeve, të kërkuar në DST sipas pikës 2.2, “Kapaciteti ekonomik dhe financiar”, pika 2.2.2.*

Referuar sa më sipër, Komisioni gjykon, se autoriteti kontraktor duhet të marrë masat e nevojshme për kthimin e situatës juridike në gjendjen fillestare për operatorin ekonomik

ankimues “Librari Dyrrahu” ShPK. Autoriteti kontraktor duhet të njoftojë ankimuesin në lidhje me arsyet e tjera të skualifikimit:

□ *Mungon paraqitja e formularit përmbledhës të vetëdeklarimit, të kërkuar në DST sipas pikës 2, “Kriteret e veçanta të kualifikimit”, germa a, shtojca 8.*

□ *Mungon licencimi për furnizime të këtij lloji ose ekuivalente, të kërkuar në DST sipas pikës 2.3, “Kapaciteti teknik”, pika 2.3.1.*

Pas momentit procedural të njoftimit të operatorit ekonomik ankimues, fillojnë afatet e ankimit, ku operatorit ekonomik i lind e drejta e ankesës në lidhje me arsyet e skualifikimit.

Për sa më sipër, pretendimet e ankimuesit qëndrojnë.

III.4. Lidhur me pretendimet e operatorit ekonomik “InfoSoft Office” SHPK, mbi kundërshtimin e arsyeve të skualifikimit nga procedura e prokurimit sipër cituar, Komisioni i Prokurimit Publik vëren se: ankimuesi kundërshton arsyet e skualifikimit me argumente (në mënyrë të përmbledhur) si vijon:

[...]..U njohëm me vendimin e KVO-së ku shoqëria jonë është skualifikuar me arsyen:

- *Vërtetimi i tatimeve, rezulton se ka detyrime (gjoba) në Tatimin në Burim në shumën 812,500 lekë për të cilën ndodhet në proces ankimimi, të kërkuar në DST sipas shtojcës 7, pika 1, “Kriteret e përgjithshme të përzgjedhjes/kualifikimit”, germa (dh).*

InfoSoft Office ShPK ka përmbushur kriteret e përgjithshme për kualifikim shtojcën 7 me plotësimin e shtojcës 8 Formulari Përmbledhës i Vetëdeklarimit dhe ky është dokument që dorëzohet në këtë fazë. AK pranon këtë dokument në fazën paraprake. Ak mund të kërkonte sqarime, në asnjë moment nuk ka tentuar të komunikojë me shoqërinë tonë. Ne kemi ngarkuar dokumente në përmbushje të kriterëve të përgjithshme për kualifikim, nuk kemi detyrime të pashlyera, por gjoba në proces ankimimi nuk përbëjnë detyrime të pashlyera referuar L.9920, dt.19.05.2008 i ndryshuar. [...]

- *Vërtetimi i OSHE, nuk përfshihet fatura koherente e muajit Nëntor, të kërkuar në DST sipas shtojcës 7, pika 1, “Kriteret e përgjithshme të përzgjedhjes/kualifikimit”, germa (e).*

[...] Vërtetimi i OSHE, nuk përfshihet fatura koherente e muajit Nëntor, të kërkuar në DST sipas shtojcës 7, pika 1, “Kriteret e përgjithshme të përzgjedhjes/kualifikimit”, germa (e). me argumente (në mënyrë të përmbledhur) si vijon: *InfoSoft Office ShPK ka plotësuar kriteret e përgjithshme për kualifikim me plotësimin e shtojcës 8 Formulari Përmbledhës i Vetëdeklarimit dhe ky është dokument që dorëzohet në këtë fazë.*

III.4.1. Autoriteti Kontraktor ka publikuar në DST shtojcën 7, Kritere të përzgjedhjes/kualifikimit, pikat dh), e) dhe shtojcën 8, Formulari Përmbledhës i Vetëdeklarimit si vijon:

Shtojca 7 [Shtojcë për t’u plotësuar nga Autoriteti Kontraktor]

FORMULAR I KRITEREVE TË PËRZGJEDHJES/KUALIFIKIMIT

1. KRITERET E PËRGJITHSHME TË PËRZGJEDHJES/ KUALIFIKIMIT

Ofertuesi deklaron se:

- a) është i regjistruar në regjistrin tregtar sipas legjislacionit të vendit ku ushtron aktivitetin, ose sipas legjislacionit të posaçëm në rastin e një organizate jofitimprurëse, ka në fushën e veprimtarisë objektin e prokurimit, dhe ka statusin aktiv;
- b) nuk është në proces falimentimi (status aktiv);
- c) nuk është dënuar për ndonjë vepër penale, në përputhje me nenin 76/1 të LPP-së;
- ç) personi (personat) që veprojnë si anëtar i organit administrativ, drejtori ose mbikëqyrësi, aksioneri ose ortaku, ose që ka fuqi përfaqësuese, vendimmarrëse ose kontrolluese brenda Operatorit Ekonomik, nuk është i dënuar ose nuk ka qenë i dënuar nga një vendimi i gjykatës i formës së prerë për çdo vepër penale, të përcaktuar në nenin 76/1 të LPP-së;
- d) nuk është dënuar me vendim gjyqësor të formës së prerë në lidhje me veprimtarinë profesionale;
- dh) Operatori Ekonomik nuk ka pagesa pashlyera të taksave dhe kontributeve të sigurimeve shoqërore, ose ndodhet në një prej kushteve të parashikuara në nenin 76/2 të LPP-së;
- e) Operatori Ekonomik ka paguar energjinë elektrike dhe plotëson kërkesat që burojnë nga legjislacioni në fuqi. Ky informacion kërkohet për Operatorët Ekonomikë, të cilët operojnë në territorin e Republikës së Shqipërisë.
- f) Operatori Ekonomik nuk është në kushtet e konfliktit të interesit, sipas legjislacionit në fuqi;
- g) Operatori Ekonomik ushtron veprimtarinë në përputhje me legjislacionin përkatës mjedisor, social dhe të punës;
- gj) Operatori Ekonomik ka paraqitur një Ofertë të pavarur, sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi;
- h) Operatori Ekonomik kryen aktivitetin në përputhje me kërkesat e legjislacionit në fuqi.
- i) operatori ekonomik nuk ka në cilësinë e anëtarit të organit të administrimit, drejtues ose mbikëqyrës i atij, aksionar ose ortak, ose me kompetenca përfaqësuese, vendimmarrjeje ose kontrolluese brenda tij persona të cilët janë/kanë qenë në këtë cilësi në një operator ekonomik të përjashtuar nga e drejta për të përfutur fonde publike, me vendim të Agjencisë së Prokurimit Publik, gjatë kohës që ky vendim është në fuqi.

Nëse gjuha e përdorur në procedurë është gjuha shqipe, atëherë dokumentet e gjuhës së huaj duhet të shoqërohen nga një përkthim i noterizuar në shqip.

Këto kritere duhet të përmbushen me paraqitjen e Formularit Përmbledhës të Vetëdeklarimit të operatorit ekonomik në ditën e hapjes së Ofertës, sipas Shtojcës 8.

Shtojca 8

(Shtojcë për tu paraqitur nga operatori ekonomik)

FORMULARI PËRMBLEDHËS I VETËDEKLARIMIT

Unë i nënshkruari _____ në cilësinë e _____ të operatorit ekonomik
_____ deklaroj nën përgjegjësinë time të plotë që:

A. Pjesa I: Informacion në lidhje me Operatorin Ekonomik

Identifikimi	Përgjigja
Emri i operatorit ekonomik: (Ju lutemi renditni të gjithë operatorët ekonomikë nëse jeni një BOE. Ju lutemi tregoni rolin e operatorit ekonomik në BOE)	-----
Numri NIPT/et:	-----
Adresa postare: Qyteti / qyteti; Kodi postar	-----
Përfaqësuesi (emri):	-----
Telefoni:	-----
E-mail:	-----

B: DEKLARATË

Për nënkontraktorët dhe subjektet në kapacitetet, e të cilave do të mbështetet Operatori Ekonomik (nëse është e zbatueshme)

Në cilësinë e operatorit ekonomik, deklaroj nën përgjegjësinë time të plotë se:

- Informacione për nënkontraktorin**

Emri i nënkontraktorit të propozuar	NIPT –i	Përqindja e nënkontraktimit	Mallrat/ shërbimet e lidhura me to për t'u nënkontraktuar

- Informacion mbi subjektet mbi kapacitetin, e të cilëve do të mbështetet operatori ekonomik**

Emri (at) e subjekteve	NIPT-i	Lloji i kapacitetit për të cilin do të mbështetet operatori	Specifiko konkretisht kapacitetin/et

		ekonomik		

Pjesa II: Shkaqet e përjashtimit

A: DEKLARATA PËR PËRMBUSHJEN E KRITEREVE TË PËRGJITHSHME TË KUALIFIKIMIT

Deklarata
<p>Operatori ekonomik është i regjistruar në regjistrin tregtar sipas legjislacionit të vendit ku ushtron aktivitetin, ose sipas legjislacionit të posaçëm në rastin e një organizate jofitimprurëse, ka në fushën e veprimtarisë objektin e prokurimit, dhe ka statusin aktiv.</p> <p><i>Sqarime nëse vlerësohet e nevojshme</i> _____</p>
<p>Operatori ekonomik nuk është dënuar për ndonjë nga veprat penale të parashikuara në nenin 76/1 të LPP-së ose ka qenë i dënuar dhe ka kaluar një periudhë 5-vjeçare nga data e ekzekutimit të dënimit, nëse nuk është përcaktuar një periudhë tjetër nga gjykata, sipas parashikimeve të nenit 76 të LPP-së.</p> <p><i>Sqarime nëse vlerësohet e nevojshme</i> _____</p>
<p>Personi / personat në cilësinë e anëtarit të organit administrativ, drejtorit ose mbikëqyrësit, si aksionar ose si ortak, ka ose kompetenca përfaqësuese, vendimmarrëse ose kontrolluese brenda operatorit ekonomik, si më poshtë:</p> <hr/> <p>etj.</p> <p>nuk janë të dënuar me vendim gjyqësor të formës së prerë për ndonjë nga veprat penale të përcaktuara në nenin 76/1 të LPP-së ose kanë qenë të dënuar dhe ka kaluar një periudhë 5-vjeçare nga data e ekzekutimit të dënimit, nëse nuk është përcaktuar një periudhë tjetër nga gjykata, sipas parashikimeve të nenit 76 të LPP-së, etj.</p> <p><i>Sqarime nëse vlerësohet e nevojshme</i> _____</p>
<p>Operatori ekonomik nuk është dënuar me vendim gjyqësor të formës së prerë për vepra që lidhen me veprimtarinë profesionale.</p> <p><i>Sqarime nëse vlerësohet e nevojshme</i> _____</p>

<p>Operatori ekonomik nuk është në proces falimentimi (statusi aktiv).</p> <p><i>Sqarime nëse vlerësohet e nevojshme</i> _____</p>
<p>Operatori Ekonomik ka paguar të gjitha detyrimet për taksat dhe kontributet e sigurimeve shoqërore, sipas legjislacionit në fuqi, ose ndodhet në një nga rastet e parashikuara në nenin 76/2 të LPP-së.</p> <p><i>Sqarime nëse vlerësohet e nevojshme</i> _____</p>
<p>Operatori ekonomik ka paguar të gjitha detyrimet e energjisë elektrike, për të gjitha adresat e ushtrimit të aktivitetit, sipas legjislacionit përkatës në fuqi.</p> <p>Ky informacion kërkohet për operatorët ekonomikë, të cilët operojnë në territorin e Republikës së Shqipërisë.</p> <p><i>Sqarime nëse vlerësohet e nevojshme</i> _____</p>
<p>Operatori ekonomik ushtron aktivitetin e tij në zbatimin e kërkesave ligjore në fuqi.</p> <p><i>Sqarime nëse vlerësohet e nevojshme</i> _____</p>
<p>Operatori ekonomik nuk është në listën e operatorëve ekonomikë të ndaluar për të fituar kontrata publike në përputhje me nenin 78 të LPP-së.</p> <p>Operatori ekonomik nuk ka në cilësinë e anëtarit të organit të administrimit, drejtues ose mbikëqyrës i atij, aksionar ose ortak, ose me kompetenca përfaqësuese, vendimmarrjeje ose kontrolluese brenda tij persona të cilët janë /kanë qenë në këtë cilësi në një operator ekonomik të përjashtuar nga e drejta për të përfituar fonde publike, me vendim të Agjencisë së Prokurimit Publik, gjatë kohës që ky vendim është në fuqi.</p> <p><i>Sqarime nëse vlerësohet e nevojshme</i></p> <p>_____</p>

B: DEKLARATA

Për Dorëzimin e Ofertave të Pavarura

Ne cilësinë e përfaqësuesit të operatorit ekonomik, në mbështetje të Ligjit Nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, si dhe në mbështetje të Ligjit Nr.9121/2003 “Për mbrojtjen e konkurrencës”, bëj këtë deklaram dhe garantoj se deklaratat e mëposhtme janë të vërteta dhe të plota në çdo aspekt:

1. Unë kam lexuar dhe kuptuar përmbajtjen e kësaj Deklarate;
2. Unë kuptoj që oferta e paraqitur do të s’kualifikohet dhe/ose përjashtohet nga fitimi i kontratave publike, nëse kjo Deklaratë vërtetohet se nuk është e plotë dhe / ose e saktë në çdo aspekt;
3. Unë jam i autorizuar nga Ofertuesi të firmos këtë Deklaratë dhe të paraqes ofertë në interes të Ofertuesit;

4. Çdo person, firma e të cilit shfaqet në dokumentacionin e ofertës, është i autorizuar nga Ofertuesi për të përgatitur dhe për të nënshkruar ofertën në interes të Ofertuesit;
5. Për qëllim të kësaj deklarate dhe ofertës së paraqitur, unë kuptoj që fjala “konkurrentë” nënkupton çdo operator tjetër ekonomik, të ndryshëm nga Ofertuesi, të paraqitur ose jo si bashkim operatorësh ekonomik, që:
 - a) paraqesin një ofertë në përgjigje të Njoftimit të Kontratës dhe/ose të Ftesës për Ofertë, të bërë nga Autoriteti Kontraktor;
 - b) është një ofertues i mundshëm, i cili bazuar në kualifikimin, aftësitë ose përvojat e tij, mundet të dorëzojë një ofertë në përgjigje, të Njoftimit të Kontratës dhe/ose të Ftesës për Ofertë.
6. Ofertuesi deklaron se: (kliko një nga alternativat e mëposhtme):
 - a) Ofertuesi ka përgatitur ofertën e tij në mënyrë të pavarur, pa u konsultuar, pa komunikuar dhe pa bërë marrëveshje apo pa rënë dakord me asnjë konkurrent tjetër;
 - b) Ofertuesi është konsultuar, ka komunikuar, ka bërë marrëveshje me një ose më shumë konkurrentë në lidhje me këtë procedurë prokurimi. Ofertuesi deklaron se në dokumentet bashkangjitur, në detajet e kësaj oferte, janë përfshirë emrat e konkurrentëve, natyra dhe shkaqet e konsultimit, komunikimit, marrëveshjes apo angazhimit (rasti i bashkimit të operatorëve ekonomikë ose nënkontraktimit).
7. Në veçanti, pa kufizuar paragrafët 6. a) dhe 6. b), të përmendur më lart, nuk ka pasur konsultime, komunikime, kontratë apo marrëveshje me ndonjë konkurrent në lidhje me:
 - a) çmimet ;
 - b) metodat, faktorët ose formulat e përdorura për llogaritjen e çmimit;
 - c) qëllimin apo vendimin për të paraqitur apo jo një ofertë; ose,
 - d) paraqitjen e një oferte që nuk i plotëson specifikimet e kërkesës për ofertë.
8. Përveç kësaj, nuk ka pasur konsultime, komunikime, marrëveshje apo kontrata me ndonjë konkurrent në lidhje me cilësinë, sasinë, specifikimet apo dërgesa të veçanta të produkteve apo shërbimeve të cilat lidhen me prokurimin në fjalë, përveç se kur janë deklaruar sipas paragrafit të mësipërm 6. b).
9. Kushtet e ofertës nuk u janë bërë të njohura dhe as nuk do t’u bëhen të njohura me qëllim nga Ofertuesi konkurrentëve të tjerë, në çdo mënyrë qoftë, para datës dhe kohës së hapjes zyrtare të ofertave, shpalljes fitues dhe lidhjes së kontratës, vetëm nëse kërkohet me ligj ose nëse deklarohen në mënyrë specifike sipas paragrafit 6.b).

C: DEKLARATA

Mbi Konfliktin e Interesit

Deklarata

Në cilësinë e operatorit ekonomik, ne deklarojmë se jemi të vetëdijshëm për sa vijon:

Konflikti i interesit është një situatë e konfliktit midis detyrës publike dhe interesit privat të një zyrtari, në të cilën ai / ajo ka interesa private direkte ose indirekte që ndikojnë, ose që mund të ndikojë ose që duket se ndikojnë në kryerjen e padrejtë të detyrave dhe detyrimeve publike.

Në përputhje me nenin 21, paragrafi 1, Ligji Nr. 9367, datë 07.04.2005, kategoritë e zyrtarëve siç parashikohen në Kapitullin III, Seksioni II, që janë absolutisht të ndaluara të përfitojnë drejtpërdrejt ose indirekt nga nënshkrimi i kontratave midis një pale dhe institucionit publik janë:

- Presidenti i Republikës, Kryeministri, Zëvendës Kryeministri, Ministrat, ose Zëvendësministrat, Deputetët, Gjyqtarët e Gjykatës Kushtetuese, Gjyqtarët e Gjykatës së Lartë, Kreu i Kontrollit të Lartë të Shtetit, Prokurori i Përgjithshëm, Gjyqtarët dhe Prokurorët në nivelin e Gjykatës së Shkallës së Parë dhe Gjykatës së Apelit, Avokati i Popullit, Anëtarët e Komisionit Qendror të Zgjedhjeve, Anëtarët e Këshillit të Lartë të Drejtësisë, Inspektori i Përgjithshëm i Inspektoratit të Lartë të Deklarimit dhe Kontrollit të Pasurive dhe Konfliktit të Interesit, Anëtarët e Enteve Rregullatore (Këshilli Mbikëqyrës i Bankës së Shqipërisë, përfshirë Guvernatorin dhe Zëvendësguvernatorin; konkurrenca; telekomunikacioni; energjia elektrike; furnizimi me ujë; sigurimi; bonot; autoritetet e medias), sekretarët e përgjithshëm të institucioneve qendrore si dhe çdo zyrtar publik në çdo institucion publik pozicioni i të cilit është i barabartë me atë të Drejtorit i Përgjithshëm, drejtuesit e organeve të administratës publike që nuk janë pjesë e shërbimit civil.

Për nëpunësit civilë të nivelit të mesëm, sipas nenit 31 dhe zyrtarët sipas nenit 32 të kreut III, seksionit 2 të këtij ligji, ndalimi në paragrafin 1 të këtij neni, për shkak të interesave private të zyrtarit, siç përcaktohet këtu të zbatohet vetëm në rast të lidhjes së kontratave brenda fushës dhe territorit të institucionit dhe juridiksionit të institucionit, ku punon zyrtari. Ky ndalim do të zbatohet edhe kur pala në kontratë është një institucion varësie.

Kur zyrtari është kryetar bashkie ose nënkryetar i një bashkie ose komune, ose kryetar i një këshilli rajonal, anëtar i këshillit përkatës, ose një zyrtar i lartë i menaxhimit të një njësie të qeverisjes vendore, ndalimi për shkak të interesave private të zyrtarit, specifikuar këtu, do të zbatohet vetëm në rastin e lidhjes së kontratave, nëse ka, me bashkinë, komunën ose rajonin ku zyrtari ushtron një detyrë të tillë. Ky ndalim do të zbatohet gjithashtu kur pala në kontratë është një institucion publik në varësi të kësaj njësie (neni 21, paragrafi 2, Ligji Nr. 9367, datë 07.04.2005).

Ndalimet e parashikuara në nenin 21, paragrafët 1, 2 të Ligjit Nr. 9367, datë 07.04.2005, me përjashtimet përkatëse, do të zbatohen në të njëjtën masë edhe për personat e lidhur me zyrtarin, d.m.th. **bashkëshortin, bashkëjetuesin, fëmijët madhorë e prindërit e zyrtarit dhe të bashkëshortit dhe bashkëjetuesit.**

Unë jam në dijeni të kërkesave dhe ndalimeve të parashikuara në Ligjin Nr. 9367, datë 07.04.2005 "Për Parandalimin e Konfliktit të Interesit në Ushtrimin e Funksioneve Publike", të ndryshuar, dhe aktet nënligjore të miratuara në bazë të tij nga Inspektorati i Lartë i Deklarimi

dhe Kontrolli i Pasurive, si dhe Ligji Nr. 162/2020, datë 23.12.2020 "Për Prokurimin Publik".

Në përputhje me to, unë deklaroj këtu se asnjë zyrtar publik, siç përcaktohet në Kapitullin III, Seksioni II të Ligjit Nr. 9367, datë 07.04.2005, dhe në këtë deklaratë, nuk ka ndonjë interes privat, direkt ose indirekt, me personin juridik që unë përfaqësoj këtu.

D: DEKLARATA

Për zbatimin e dispozitave ligjore në marrëdhëniet e punës

Deklarata

Në cilësinë e operatorit ekonomik, deklaroj nën përgjegjësinë time të plotë se:

- Operatori ekonomik _____garanton mbrojtjen e të drejtës së punësimit dhe profesionit nga çdo formë diskriminimi, të parashikuar nga legjislacioni i punës në fuqi.
- Operatori ekonomik_____lidh me punëmarrësit kontratat përkatëse të punës dhe garanton masat në drejtim të sigurisë dhe shëndetit në punë për të Gjithë dhe, në mënyrë të veçantë, për grupet e rrezikuara, bazuar në legjislacionin e punës në fuqi.
- Operatori ekonomik _____nuk ka masë Ligjore në fuqi, të vendosur nga Inspektorati Shtetëror i Punës dhe Shërbimeve Shoqërore (ISHPSHSH). Në rastet kur janë konstatuar shkelje ligjore, operatori ekonomik ka marrë masat e nevojshme për adresimin e tyre, brenda afateve të përcaktuara nga ISHPSHSH.

Sqarime nëse vlerësohet e nevojshme

Pjesa III Kriteret e Përzgjedhjes/Kualifikimit

A: DEKLARATË

Në përputhje me specifikimet teknike dhe grafikun e realizimit të objektit të kontratës:

Deklarata	Përgjigje
Në cilësinë e operatorit ekonomik, ne deklarojmë se plotësojnë të gjitha specifikimet teknike, siç udhëzohet në dokumentet e tenderit, dhe këtë e provojmë përmes certifikatave dhe dokumenteve të paraqitura me këtë deklaratë (nëse kërkohet nga Autoriteti Kontraktor), dhe marrim përsipër të realizojmë objektin në përputhje me Listën e mallrave dhe grafikun e lëvrimit të përcaktuar nga Autoriteti kontraktor.	Po [] Jo []

B: DEKLARATË

Për disponimin e punonjësve dhe makinerive të nevojshme (nëse kërkohen)

Deklarata	Përgjigje
<p>Në cilësinë e operatorit ekonomik, deklaroj nën përgjegjësinë time të plotë se:</p> <p>Unë kam punonjësit e nevojshëm si dhe mjetet dhe makineritë për ekzekutimin e kontratës, siç përcaktohet në dokumentet e tenderit, dhe e vërtetoj këtë me dokumentacionin përkatës, të cilin do ta paraqes në kopje origjinale ose të noterizuar nëse fitoj, ose nëse më kërkohen sqarime nga autoriteti kontraktor.</p>	<p><u>Punonjës</u></p> <p>Po [] Jo []</p> <p>Nëse, po, numri i punonjësve:</p> <hr/> <p>Profili i punonjësve</p> <hr/> <p><u>Makineri e mjete</u></p> <p>Po [] Jo []</p> <p>Nëse po, të listohen me të dhënat konkrete:</p> <hr/>
<p>Emri, Mbiemri _____</p> <p>Firma _____</p> <p>Vula _____</p> <p>Data e dorëzimit të deklaratës _____</p>	

Ju lutemi sigurohuni që:

- Secili pjesëmarrës i renditur në një bashkim operatorësh ekonomikë të paraqesë një Formular të veçantë të Vetëdeklarimit.
- Në rast se, operatori ekonomik ofertues do të mbështetet në kapacitetet e subjekteve të tjera, një Formular i veçantë i Vetëdeklarimit duhet të paraqitet edhe nga subjekti mbështetës.
- Çdo vetdeklarim i pavërtetë/pasaktë nga ana e operatorëve ekonomikë jo vetëm që përbën shkak për skualifikimin nga procedura konkrete, por përbën shkak edhe për përjashtimin e tyre nga e drejta për të fituar kontrata publike deri në 3 vjet, sipas parashikimeve të ligjit për prokurimin publik.
- Operatorët ekonomikë që ofertojnë në procedurat e prokurimit të vetdeklarojnë në çdo rast informacionin e saktë që i korrespondon gjendjes së tyre faktike.

Në çdo rast, autoriteti kontraktor ka të drejtë të kryejë verifikimet e nevojshme për vërtetësinë e informacionit të deklaruar nga operatori ekonomik për sa më sipër.

- Në çdo rast, përpara publikimit të njoftimit të fituesit paraprak dhe nisjes së afateve të ankimit, autoriteti kontraktor duhet t'i kërkojë ofertuesit fitues që të dorëzojë dokumentet provuese për vetëdeklarimet në formularin përmbledhës të vetëdeklarimit, si dhe dokumentet e paraqitura si pjesë e ofertës në rrugë elektronike. Këto dokumente duhet të paraqiten në original ose në kopje të njësuara me origjinalin.
- Informacioni i pasqyruar në formularin e vetëdeklarimit, i cili gjendet në një bazë të dhënash, ku autoriteti kontraktor mund të aksesojë direkt këtë informacion dhe /ose dokumentin, duhet të shoqërohet me adresën përkatëse për këtë bazë të dhënash.

III.4.2 Komisioni vëren, se referuar legjislacionit në fuqi për prokurimin publik, vendosja e kriterëve të përgjithshme dhe të veçanta për kualifikim ka si synim kryesor që t'i shërbejë autoritetit kontraktor për njohjen e gjendjes dhe kapaciteteve të operatorëve ekonomikë, të cilët, nëpërmjet dokumentacionit të paraqitur duhet të vërtetojnë se zotërojnë kualifikimet e nevojshme teknike, profesionale, kapacitetet ekonomike, financiare dhe organizative, makineritë, pajisjet e asete të tjera fizike, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm, gjithçka në funksion të realizimit me sukses të kontratës në respekt të Ligjit 162/2021“Për Prokurimin Publik”.

Operatorët ekonomikë pjesëmarrës duhet të vërtetojnë, se zotërojnë reputacionin, besueshmërinë dhe dëshmi për mjetet dhe pajisjet teknike që ka në dispozicion apo që mund t'i vihen në dispozicion operatorit ekonomik, për të zbatuar kontratën objekt - prokurimi, si edhe janë të detyruar të përgatisin oferta, në përputhje me kërkesat e përcaktuara në dokumentet e tenderit, në mënyrë që edhe vlerësimi të bëhet në përputhje me këtë dokumentacion.

Autoriteti kontraktor do të konsiderojë një ofertë të vlefshme, vetëm nëse ajo është në përputhje me të gjitha kërkesat dhe specifikimet e përcaktuara në njoftimin e kontratës dhe në dokumentet e tenderit. Për pasojë, Komisioni gjykon, se operatorët ekonomikë pjesëmarrës në një procedurë prokurimi duhet të plotësojnë vetëm kërkesat e vendosura në dokumentet e tenderit, e rrjedhimisht, vlerësimi e kualifikimi i tyre duhet të bëhet në përputhje vetëm me këto kërkesa.

Referuar pikës 1 dhe 6 të nenit 26, “Formulari përmbledhës i vetëdeklarimit”, të VKM-së nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar, parashikohet shprehimisht se: “Bashkë me dorëzimin e kërkesave për pjesëmarrje ose të ofertave, **autoriteti/enti kontraktor pranon si provë paraprake, në vend të disa vërtetimeve të lëshuara nga autoritetet publike ose palë të treta, formularin përmbledhës të vetëdeklarimit, sipas përcaktimit në nenin 82, të LPP-së, dhe në këto rregulla.** 2. Formulari përmbledhës i vetëdeklarimit përmban informacion dhe deklarimin, si më poshtë vijon: i) operatori ekonomik disponon mjetet dhe makineritë e nevojshme për ekzekutimin e kontratës, sipas kërkesave të autoritetit/entit kontraktor, kur është rasti; 6. **Përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, autoriteti/enti kontraktor i kërkon ofertuesit të kualifikuar, i pari dorëzimin e dokumenteve provuese të parashikuara në shkronjat “a”, “b”, “d”, “dh”, “e”, “h”, “i”, “j” të pikës 2 të këtij neni, si dhe dokumentet**

e tjera shoqëruese të ofertës, të dorëzuara në rrugë elektronike. Këto dokumente duhet të paraqiten në origjinal ose në kopje të njësuara me origjinalin.

Nga shqyrtimi i dokumentacionit të administruar, Komisioni i Prokurimit Publik konstaton, se në përmbushjen e Kritereve të përgjithshme të përzgjedhjes/kualifikimit në shtojcën 7, operatori ekonomik ka ngarkuar në SPE dokumentacionin e ofertës, shtojcën 8, Formulari Përmbledhës i Vetëdeklarimit me emërtim *Shtojca_8_ Formulari_Përmbledhes_i_Vetedeklarimit*, ku në pjesën A: DEKLARATA PËR PËRMBUSHJEN E KRITEREVE TË PËRGJITHSHME TË KUALIFIKIMIT, ka plotësuar formularin në përmbushje të kërkesave të përgjithshme për kualifikim. Gjithashtu, bashkëlidhur ka publikuar dokumentet:

Tatime_31_01_2020_vendimi_i_gjykates Infosoft.

Vërtetim_likuidimi_të_Taksave_dhe_Tarifave_Vendore_Bashkia_Tiranë Infosoft.

Vërtetim_Tatime_30.11.2023 Infosoft.

Vërtetim_OSHEE_13.12.2023 Infosoft

Komisioni i Prokurimit Publik gjykon, se operatori ekonomik ankimues ka paraqitur të gjithë dokumentacionin në përputhje me kriteret dhe kërkesat e autoritetit kontraktor, të përcaktuara në dokumentet e tenderit. Në respektim të legjislacionit sipër cituar, autoriteti kontraktor duhet të pranohet Formularin Përmbledhës të Vetëdeklarimit, në përmbushje të kritereve të përgjithshme për kualifikim, në fazën e vlerësimit të ofertave.

Për sa më sipër referuar, pretendimet e ankimuesit qëndrojnë.

III.5. Në lidhje me pretendimet e operatorit ekonomik “Librari Dyrrahu” SHPK me argumentin “*të qëndrojnë i njëjti vendim për OE të skualifikuar InfoSoft Office*”, Komisioni i Prokurimit Publik në pikën III.4. e në vijim të këtij vendimi është shprehur duke vendosur shfuqizimin e vendimit të KVO-së lidhur me arsyet e skualifikimit të operatorit ekonomik “InfoSoft Office” SHPK. Rrjedhimisht pretendimet e “Librari Dyrrahu” SHPK nuk do të merren në shqyrtim pasi përbëjnë gjë të gjykuar për Komisionin.

Për sa më sipër, në mbështetje të neneve 30, dhe 118 të ligjit nr. 162/2020 “*Për Prokurimin Publik*”, Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 285, datë 19.05.2021 “*Për miratimin e rregullave të prokurimit publik*”, i ndryshuar, Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 236, datë 20.04.2023, “*Për përcaktimin e rregullave dhe tarifës së pagesës për ankimin në një procedurë prokurimi, pranë Komisionit të Prokurimit Publik*”, Vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik Nr. 766, datë 13.10.2021 “*Për miratimin e rregullave “Për Organizimin dhe Funksonimin e Komisionit të Prokurimit Publik*”, nenit 4, të Vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik nr. 500/2020 datë 5.11.2020 “*Rregullore për Marrjen e Masave Organizative për Ushtrimin e Veprimtarisë së Institucionit të Komisionit të Prokurimit Publik gjatë gjendjes së pandemisë së shkaktuar nga COVID -19*”, Komisioni i Prokurimit Publik, njëzëri,

Vendos:

1. Të pranojë ankesën e operatorit ekonomik “Librari Dyrrahu” SHPK, në lidhje me arsyen e parë të skualifikimit për procedurën e prokurimit “*Procedurë e Hapur e Thjeshtuar*”, me Nr. REF-82208-10-04-2023, me objekt “Blerje materiale kancelarie për Bashkinë Fushë-Arrëz”, me fond limit 1,384,166 lekë pa TVSh, zhvilluar më datë 19.12.2023, nga autoriteti kontraktor, Bashkia Fushë-Arrëz.
 2. Autoriteti kontraktor të njoftojë operatorin ekonomik “Librari Dyrrahu” SHPK, në lidhje me arsyet e tjera të skualifikimit, sipas Raportit Përmbledhës dhe Formularit të Njoftimit të Fituesit Paraprak të Procedurës sipër cituar.
 3. Të pranojë ankesën e operatorit ekonomik “InfoSoft Office” SHPK për procedurën e prokurimit “*Procedurë e Hapur e Thjeshtuar*”, me Nr. REF-82208-10-04-2023, me objekt “Blerje materiale kancelarie për Bashkinë Fushë-Arrëz”, me fond limit 1,384,166 lekë pa TVSh, zhvilluar më datë 19.12.2023, nga autoriteti kontraktor, Bashkia Fushë-Arrëz.
 4. Të kualifikojë operatorin ekonomik “InfoSoft Office” SHPK në procedurën e prokurimit sipër cituar.
 5. Autoriteti kontraktor të anulojë vendimin e KVO mbi skualifikimin e ofertës së operatorit ekonomik “InfoSoft Office” SHPK dhe të korrigjojë shkeljet e konstatuara në këtë vendim.
 6. Autoriteti kontraktor të anulojë vendimin e KVO mbi arsyet e skualifikimit të operatorit ekonomik “Librari Dyrrahu” SHPK duke e kualifikuar atë për arsyen e parë të skualifikimit, sipas rekomandimeve të këtij vendimi.
 7. Ngarkohet zyra e financës të kryejë veprimet përkatëse për kthimin e tarifës financiare të paguar nga operatori ekonomik “Librari Dyrrahu” SHPK.
 8. Ngarkohet zyra e financës të kryejë veprimet përkatëse për kthimin e tarifës financiare të paguar nga operatori ekonomik “InfoSoft Office” SHPK.
 9. Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative të Apelit.
 10. Kopje e këtij vendimi i dërgohet për njoftim Agjencisë së Prokurimit Publik.
- Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK

Anëtar
Kreshnik Ternova

Anëtar
Anila Malaj

Kryetar
Jonaïd Myzyri

